

**Akt Themelimi**  
i shoqërise me përgjegjësi të kufizuar **"RHINALB S.R.L"**

Mbështetur në Kushtetutën dhe Kodin Civil në fuqi të Republikës së Shqipërisë, në Ligjin Nr. 9901 datë 14.04.2008, "Për Shoqëritë Tregtare" dhe në Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Q.K.R" dhe formalitetet që duhen respektuar nga Shoqëritë Tregtare, me vullnetin e tyre të lirë, të shprehur edhe në nënshkrimin e këtij akt-themelimi, sot më datë 24/10/2022 me ortakët :

**1. Rezart SHEHU me ID H51010160U**

krijojmë shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar **"RHINALB S.R.L"** me akt themelimi si vijon:

**Neni 1**

Formimi i shoqërisë

Formohet shoqëria tregtare private e quajtur **"RHINALB S.R.L"**. Shoqëria do të nënshtrohet legjislacionit shqiptar, ndërsa degët që mund të krijohen do të nënshtrohen legjislacionit ku do të ketë selinë dega. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij akti themelues dhe statutit të shoqërisë që do të miratohet nga ortakët themelues.

**Neni 2**

Selia e shoqërisë

- Selia e shoqërisë **"RHINALB S.R.L"** do të jetë: Fier, Roskovec, Lagjja Nr.1, Rruga e Ngjeqarit, Ndertesa Nr.8, pasuri e paluajtshme Truall dhe Ndertese me Sip.575 m2. Adresa e shoqërisë për qellime komunikimi elektronik është si vijon: [rhinosafety.srl@gmail.com](mailto:rhinosafety.srl@gmail.com)

Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hapë zyra përfaqësie, degë, të krijojë filiale si brenda ashtu dhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të asamblesë së ortakëve.

**Neni 3**

Objektivi i veprimtarisë

Shoqëria do të zhvillojë veprimtaritë si vijojnë:

- Aktivitet në fushën e fasonerisë: prerje, qepje, montim suprina kepucesh, kepuce të gjitha llojeve e formave, tregtim me pakice e shumice e tyre. Import-eksport materiale industriale ndryshme, makineri e pajisje, lende të para et. Aktivitet në fushën e tregtisë: tregti me shumice e pakice të materialeve të ndryshme të gjitha llojeve etj.

**Neni 4**

Kohëzgjatja e shoqërisë

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar. Ajo mund shpërbehet në çdo kohë dhe për çfarëdo lloj shkak.

**Neni 5**

Kapitali i shoqërisë

Kapitali fillestar i shoqërisë private **"RHINALB S.R.L"** do të jetë 100 (njëqind) Leke dhe është 1 kuote.

1. Ortaku themelues **Rezart SHEHU me Nipt H51010160U** Zotërues i 1 kuote që përbëjnë 100% të kapitalit themelues të shoqërisë. (100 njëqind lekë)

**Neni 6**

Drejtimi i shoqërisë

Shoqëria do të drejtohet nga administratori Z. **Rezart SHEHU**. Ai është përfaqësuesi i shoqërisë në marrëdhënie me të tretet dhe ka kompetenca të plota në drejtimin e saj .  
Cdo kontrate do të kryhet prej tij dhe në rast mungese nga një përfaqësues i pajisur me prokurë të posacme .

**Neni 7**

Ortakët themelues kanë të drejte të emërojnë dhe administratorë të tjerë të vlerave materiale, kanë të drejtë të caktojnë financiarë dhe likuidatorë për problemet e shoqërisë.

**Neni 8**

Konfliktet që mund të lindin do të zgjidhen në zbatim të legjislacionit Shqiptar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë .

**Neni 9**

Shoqëria ka vulën e saj me madhësi të zakonshme , me tekstin rreth saj .

**Neni 10**

Shoqëria deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe vecanerisht të Ligjit Nr.9901 datë 14.04.2008 “Për Krijimin e Shoqërive Tregtare” , si dhe duke zbatuar ligjet ndërkombetare dhe të vendit si dhe rregullave që zbatohen për biznesin që kryen kjo shoqëri .

**Neni 11**

Akti i themelimit u përpilua në 2 kopje , për t'ju shpërndare organeve kompetente dhe një kopje do të mbetet në dokumentacionin bazë të shoqërisë “**RHINALB S.R.L**” .

Akti i themelimit nënshkruhet rregullisht nga ortaku i vetëm .

Ortaku

**Rezart SHEHU**

